



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 247/4 Prot

Tiranë, më 14.06.2022

V E N D I M

Nr.83, datë 14.06.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së disa pretendimeve të parashtruara nga konkurenti *** , në lidhje zhvillimin e procedurës së konkurrimit, me kod # 00000684, “Pranim nga jashtë shërbimit civil” në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori-Sektori i Projekteve dhe Praktikave, Drejtoria e Trajnim Zhvillimit ”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Tiranë - (kategoria III-a).**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e konkurentit ***** ,

Vërej se:

Konkurenti ***** , nëpërmjet një kërkesë të protokolluar me nr. 247 prot., datë 29.03.2022, ka parashtruar se Bashkia Tiranë, gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit për “Pranim nga jashtë shërbimit civil” në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese, për shpalljen e pozicionit me kod # 00000684, “Përgjegjës Sektori - Sektori i Projekteve dhe Praktikave, Drejtoria e Trajnim Zhvillimit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore”, nuk ka respektuar procedurën ligjore, duke mos shpallur në faqen zyrtare aplikantët dhe ka pretenduar se nëpunësit e bashkisë me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë ndërhyrë haptazi në konkurimin publik, si rrjedhojë kanë shkelur Kushtetutën e ligjet e këtij vendi, duke cënuar të drejtat themelore kushtetuese të individëve konkurrues dhe besimin e publikut mbi zhvillimin e këtyre konkurseve.

Mbi bazën e informacionit të mësipërm ka nisur verifikimi i këtij rasti, duke kërkuar sqarimet dhe dokumentacionin e nevojshëm nga ana e Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 247/1, datë 12.04.2022, me objekt *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e kërkesës së aplikantit *****, për procedurën e rekrutimit”*, nga përmbajtja e të cilave rezultoi si më poshtë:

Bashkia Tiranë në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242 datë 18.03.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, me shkresën nr.4968 datë 02.02.2022 me objekt *“Shpallje për vende të lira pune”*, dërguar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ka shpallur procedurën në fjalë, shpallje e cila është publikuar në faqen e web-it të Bashkisë Tiranë dhe në stendat e informimit të qytetarëve.

Afati për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit online, për procedurën e lëvizjes paralele, sipas publikimit të Bashkisë Tiranë, ishte në datën 13.02.2022, ndërsa për procedurat: *ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil*, ishte vendosur në datën 18.02.2022.

Çdo kandidati të kualifikuar i është dërguar e-mail nga njësia përgjegjëse, pas verifikimit paraprak për datën që do të zhvillohej konkursi. Në momentin që punonjësit e saj kanë konstatuar që data e testimit për pozicionin: *“Përgjegjës Sektori - Sektori i Projekteve dhe Praktikave, Drejtoria e Trajnim Zhvillimit”*, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Tiranë, e vendosur si datë 13.03.2022, rezultonte të ishte ditë e dielë, *(pra ditë pushimi)*, e për këtë arsye njësia përgjegjëse, ka përsëritur njoftimin për të gjithë konkurrentët e kualifikuar nëpërmjet adresave personale të e-mailit, për zhvillimin e procesit të konkurrimit, duke e afruar datën në 11.03.2022.

Pas çeljes së procedurës në datën 11.03.2022, Komiteti i Pranimet për *Ngritje në Detyrë*, ka vendosur përfundimin e procedurës pa fitues, duke qënë se në ditën e zhvillimit të konkursit, nuk ishte paraqitur asnjë kandidat.

Duke analizuar veprimet si më sipër, konstatojmë se njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë ka vepruar në përputhje me procedurën ligjore dhe duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe Kreut II, pika 11, dhe III, pika 22, të Vendimit nr. 242 datë 18.03.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, në të cilat përcaktohet se: *“...Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimet të dokumentave, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.*

Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.”

Si rrjedhojë, në zbatim të afateve ligjore të përcaktuara në pikën 11, Kreu II dhe 22, Kreu III të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 “*Për Plotësimin e Vëndeve të lira në kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese*”, për procedurën e lëvizjes paralele, rezultatet për fazën e verifikimit paraprak është vendosur të publikohen në datën 15.02.2022, ndërsa për procedurat: “*Ngritje në Detyrë*” dhe “*Pranim nga jashtë shërbimit civil*”, është vendosur të shpallen në datën 28.02.2022.

Duke vazhduar më tej me shqyrtimin e akteve të administruara, rezulton se njësia përgjegjëse, nëpërmjet postës elektronike me adresë rekrutime.bashkia@tirana.al, përkatësisht në datën 02.03.2022 ka njoftuar gjithë konkurrentët e kualifikuar (*ndërmjet të cilëve edhe konkurrentin ******, në orën 11:27 AM), si dhe ka afishuar në stendën e lajmërimeve për publikun, se testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 11.03.2022 ora 11, ndërsa intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohej në të njëjtën datë, në orën 12, në ambjentet e Bashkisë Tiranë.

Më pas, konstatohet se në datën dhe orën e caktuar, është mbledhur KPND, dhe anëtarët e tij kanë hartuar deklaratën “*Për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të komitetit të pranimit për procedurën “Ngritje në Detyrë”*”. Pas kësaj, nga verifikimi ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë nga kandidatët e kualifikuar paraprakisht e për këtë është hartuar procesverbali i konstatimit duke evidentuar në përmbajtjen e tij se në datën e zhvillimit të konkursit, nuk është paraqitur asnjë prej kandidatëve e për rrjedhojë procedura është përmblyllur pa kandidat fitues.

Por, pavarësisht faktit se konkurrimi është përmblyllur pa fitues, evidentohet fakti se nga ana e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, është lejuar një shkelje e procedurës ligjore, pasi nuk janë publikuar në faqen zyrtare emrat e konkurrentëve të kualifikuar, ç’ka vjen në kundërshtim me pikën 24, të Kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: “*...Lista e përmendur në pikën 23 të kreut III të këtij vendimi administrohet nga njësia përgjegjëse dhe shpallet në:*

a) *Faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për administratën shtetërore;*

b) *Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në ambjentet e brendshme, për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.”*

Një mosveprim i tillë përbën, cenim të parimeve të transparencës dhe të informimit, parashikuar nga nenet 5 dhe 6, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i*

RSH”, gjë e cila mund të këtë krijuar kushte për mosnjohimin në kohë të konkurrentëve, gjë e cila ndikoi në dështimin e procesit të konkurrimit dhe mosplotësimin e pozicioneve të lira.

Për këtë mosveprim, duhet ti tërhiqet vëmendja njësisë përgjegjëse të Bashkisë, e cila kishte detyrimin që në faqen e web-it <http://lgu.dap.gov.al/api/publicationDocumentId/2656>, krahas publikimit të shpalljes me kod # 00000684, të publikonte edhe emrat e konkurrentëve të kualifikuar.

Në mbështetje të arsytimit të mësipërm dhe në kushtet kur konkurrimi ka përfunduar pa fitues, shkelja e kryer nuk mund të klasifikohet si një shkelje e natyrës që passjell pavlefshmëri absolute të procesit. Për më tepër, në kushtet kur njoftimet përkatëse janë bërë personalisht tek secili prej pjesëmarrësve dhe procesi i konkurrimit do të përsëritet, ç’ka i jep mundësi konkurrentëve të mëparshëm, bashkë me konkurrentët e tjerë që mund të tregojnë interes, të marrin pjesë në të, vlerësojmë që në këtë rast të mjaftohet me tërheqjen e vëmëndjes njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, të mos lejojë veprime apo mosveprime të tilla, në të ardhmen.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin që në rastin konkret nuk ka vend për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit administrativ dhe se çështja duhet të arkivohet, duke nënvizuar detyrimin që njësia përgjegjëse të mbajë parasysh rekomandimin e mësipërm në lidhje me publikimin e emrave të kandidatëve të kualifikuar, jo vetëm në stendën e lajmërimeve për publikun, por edhe në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” e në faqen zyrtare të internetit të institucionit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, 26 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Kreut II pika 11 dhe III, pika 22 të Vendimit nr. 242 datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, bazuar në nenin 5, 6, 90, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së zhvillimit të procesit të konkurrimit, për shpalljen me kod # **00000684**, për plotësimin e pozicionit “*Përgjegjës Sektori - Sektori i Projekteve dhe Praktikave, Drejtoria e Trajnim Zhvillimit*” në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore

dhe meqënëse gjithë veprimet administrative të kryera, gjënden në përputhje me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, për të cilat u fol hollësisht në pjesën arsyetuese të vendimit, çështja të arkivohet.

2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, të mbajë parasysh rekomandimin e mësipërm në lidhje me publikimin e emrave të kandidatëve të kualifikuar, jo vetëm në standin e lajmërimeve për publikun, por edhe në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” e në faqen zyrtare të internetit të institucionit.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Tiranë dhe konkurrenti *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha